

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"VIVE-DENTAL CLINIC" SH.P.K**

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 7850, dt. 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, më datë 28.03.2024, me vullnetin e lirë personat si më poshtë:

- **Z. Besnik Rusi**, shtetas Shqiptar, lindur më 12.03.1953, në Shkodër dhe banues në Shkodër, identifikuar me ID nr. 034150740, Nr. Personal F30312109R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Agim Mehmeti**, shtetas Shqiptar, lindur më 24.06.1976, në Durrës dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID Nr. 036963348, Nr. Personal H60624133S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Elton Tirana**, shtetas shqiptar, lindur më 24.02.1974, në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID Nr. 032927475, me Nr. Personal H40224146M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kanë hartuar Aktin e Themelimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Shoqëria është emërtuar "VIVE-DENTAL CLINIC" Sh.p.k.

**Neni 2 – Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga "Medar Shtylla", Nd.47, H.23, Ap. 8, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose filiale brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Klinikë dentare dhe laborator dentar;
- Ortondonci dhe implantologji;
- Shërbime të grafisë dentare;
- Turizëm dentar, ofrimin e të gjitha shërbimeve dentare pacientëve të huaj, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin, guidën turistike, etj.;
- Kirurgji dentare;
- Kirurgji orale;
- Punime protetike orale;
- Terapi dentare;
- Shërbime dentare estetike;
- Importim dhe eksportim të tregtisë me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe medikamenteve mjekësore dentare;

Faqe 1 e 3

AKT THEMELIMI i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
"VIVE-DENTAL CLINIC" Sh.p.k.

- Aktivitete të ndryshme në fushën e mjekësisë estetike dhe stomatologjisë.

#### **Neni 5 – Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 ((Njëqind) Lekë dhe është i ndarë në 3 kuota, të cilat i përkasin ortakëve si më poshtë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

1. **Z. Besnik Rusi** me vlerë 33.33 (Tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) Lekë, e cila përbën 33.33% të kapitalit të shoqërisë.
2. **Z. Agim Mehmeti** me vlerë 33.33 (Tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) Lekë, e cila përbën 33.33% të kapitalit të shoqërisë.
3. **Z. Elton Tirana** me vlerë 33.34 (Tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër) Lekë, e cila përbën 33.34% të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin e saj deri në kufirin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### **Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- Trashëgimisë;
- Dhurimit;
- Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ose tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **Neni 7 – Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Kompetencat e Aksionarëve rregullohen në Statutin e Shoqërisë.

#### **Neni 8 – Administratori**

Me këtë Akt emërohet Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Erald Rusi**, shtetas Shqiptar, lindur më 09.07.1986 në Shkodër dhe banues në Shkodër, identifikuar me ID Nr. 036296100, Nr. Personal I60709084H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Afati i emërimit të Administratorit është për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data e emërimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Kompetencat e Administratorit rregullohen në Statutin e Shoqërisë.

#### **Neni 9 – Personaliteti juridik dhe veprimtaria e Shoqërisë**



Personalitetin juridik Shoqëria e fiton në momentin e regjistrimit të saj si person juridik në regjistrin tregtar pranë QKB-së, ndërsa të drejtën për të vepruar sipas objektit të saj Shoqëria e fiton në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë nga organet tatimore.  
E gjithë veprimtaria e Shoqërisë do të zhvillohet në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit të Shoqërisë dhe dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

**Neni 10 – Legjislacioni**

Përsa nuk është shkruar në këtë Akt Themelimi dhe në Statut, legjislacioni i zbatueshëm do të jetë Legjislacioni tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 11 – Efektet**

Efektet e këtij Akti nisin që nga momenti i nënshkrimit të tij.

**ORTAKËT  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"VIVE-DENTAL CLINIC" SH.P.K**

Beshike Rusi

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



AGIM MEHMETI

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



ELTON TIERA

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

